LIGJ
Nr.10 452, datë 21.7.2011

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË TË MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR, PËR BASHKËPUNIMIN PËR INFORMACIONIN ATOMIK

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli që ndryshon aneksin e sigurisë të marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin për informacionin atomik, bërë në Bruksel më 2 qershor 1998.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7066, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLL
QË NDRYSHON ANEKIN E SIGURISË SË MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

duke patur parasysh që zhvillimet në sigurinë e informacionit atomik kërkojnë rishikimin e shpeshtësisë së inspektimit të plotë të sigurisë së të gjithë elementëve ushtarakë dhe civilë të NATO-s dhe të shteteve anëtare që kanë marrë informacion në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik,

Palët e poshtëshënuara kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Aneksi i sigurisë së marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për Bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, bërë në Paris më 18 qershor 1964, ndryshohet sipas parashikimit në nenin 2.

Neni 2

Fjalia e parë e seksionit 10, Inspektimet e Sigurisë, paragrafi A, e aneksit të Sigurisë së Marrëveshjes ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik zëvendësohet me fjalinë e mëposhtme:

"A. Inspektimi i plotë i sigurisë së të gjithë elementëve ushtarakë dhe civilë të NATO-s

dhe shteteve anëtare që kanë marrë informacion atomik sipas marrëveshjes kryhet rregullisht, gjatë një periudhe që përcaktohet nga Këshilli i Atlantikut Verior me kriteret e parashikuara në seksionin I, paragrafi A i këtij aneksi.”.

Neni 3

Ky protokoll hyn në fuqi me marrjen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit nga të gjitha shtetet palë në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, që ata kanë vullnetin t’i nënshtrohen termave të këtij protokolli.

Neni 4

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon të gjitha palët dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior për çdo njoftim dhe për hyrjen në fuqi të këtij protokolli.

Neni 5

Ky protokoll mban datën në të cilën është hapur për nënshkrim dhe mbetet i hapur për nënshkrim derisa të nënshkruhet nga të gjitha palët në Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Bruksel, më 2 qershor 1998, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje origjinale të vetme që depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila u transmeton kopje të certifikuara të saj të gjitha Shteteve nënshkruesve dhe aderuese.